

2PC 0009515

05.10.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit - Opština Dragas
Direktorati për Arsimit dhe Kulturë
Direktorijati za Prosvetu i Kultura

Nr. Br. 131777

06.10.2021

Dragash - Dragas



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova/ Republika of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragas/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, Kapitullit V nenit 67 dhe 68, e në bazë Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr:151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo- Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratave dhe Emërimit të Përkohshme, Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash,shpall:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

I.Titulli i vendit tëpunës: Drejtor në Shkollat fillore të mesme të ulëta (Shfmu)

Nr.	Shkolla	Vendi	Titulli i mbikëqyrës	Lloji i pozitave	Titulli i punës	Koeficienti	Orë në javë	Kohëzgjatja e emërimit
1.	Shfmu "Zenuni"	Brod	Drejtori i Arsimit	Jo karrierë	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
2.	Shfmu " Sezai Surroi"	Bellobrad	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite

Institucioni: Komuna e Dragashit

Departamenti/Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Lloji i pozitës: Jo karrierës

Numri i Pozitave: dy(2) pozita

Titulli i mbikëqyrës: Drejtori i Arsimit

Grada/Koeficienti: Koeficienti -7.8

Orët e punës: 40

Kohëzgjatja e emërimit: 4 vite

Qëllimi i vendit të punës

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e arsimit
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe afatgjatë për aktivitetin e drejtorisë;

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës
- Aftësimin e personelit në Institucion;
- Planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlukuara të praktikës;
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin të gjitha aktiviteteve në Institucion;
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjeve, udhëzimit administrativ në fuqi dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
 - Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit;
 - 1.Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim(kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar)
 - 2.Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar)
 - 3.Katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar)
 - 4.Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar)
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit KSHL
 - Të ketë përvojë pune në procesin edukativ –arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 - 1.Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë:
 - 2.Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në niveleve tjera:
 3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor.
- Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet të jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurren.

Dokumentet e nevojshme:

- } Certifikata e lindjes;
- } Diploma e fakultetit-masterittë kryer për nivelin përkatës;
- } Dëshminë për përvojën e punës;
- } Portofolin profesionale;
- } Letërreferencë nga një institucion publik –kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, Institucionet e Arsimit të lartë).
- } Letrate referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- } Planin zhvillimor të institucionit edukativo arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it;
- } Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësori licencuar me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- } Dëshminë se nuk është nën hetime;
- } Kopja e letërnjoftimit.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 08 ditë kalendarike, pas kalimit të afatit 30 ditor si njoftim, perkatesisht aplikimi behet nga data 04/11/2021 deri me 11/11/2021 Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në DKA, apo ti shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Dragashit <https://kk.rks-gov.net/dragash/> dhe portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuar ti dorëzojnë në DKA zyra nr.5.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.



Drejtori i Arsimit në Dragash

MSc. Vloran Cenaj